



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 954 /2011

Datë: 10.05.2011

Bazuar në nenin 101 pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenin 10 pika 1.3 dhe nenit 17 pika 1 paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe pika 2 dhe 3 e Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datën 04.05.2011, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime të Kolegjit të Këshillit në përbërje Bajram Ajeti, kryetar, Irena S. Ahmedi, anëtare dhe Zyle Gojnovci-Millaku, Zyrtare e mbikëqyrjes, pas monitorimit që kanë bërë në Ministrinë e Financave me datën 08.03.2011, me qëllim të respektimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil, lëshon këto:

REKOMANDIME

I. Në funksionin mbikëqyrës për zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për Shërbimin Civil të Kosovës, në Ministrinë e Financave duhet të ndermiren këto veprime:

1. Obligohet Ministria e Financave që të bëjë riorganizimin e njësive të personelit (burimeve njerëzore), konform nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 41 të Ligjit të Administratës Shtetërore.
2. Të anulohet konkursi i publikuar më datën 06.01.2011 dhe rishpallur më datën 28.01.2011 me nr. të referencës 001/2011-DB për postin -Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit, sepse është bërë në kundërshtim me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenin 9 parag.2 nën-parag. 2.2 pika 2.2.3 pa përcaktuar llojin e pozitës; nenin 11 parag. 3, pa dëshmi mbi aprovimin e inicimit të rekrutimit nga menaxheri i personelit dhe aprovuar nga Zyrtari kryesor Administrativ; nenin 12 parag.1 nën-parag.1.2 dhe 1.4 pa miratuar buxheti, nenin 16 ku konkursi nuk përmban të gjitha elementet e përcaktuara, nenin 17 parag.1 nën-parag.1.2 dhe 1.3 nuk është publikuar siq është përcaktuar me këtë nen dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve, nenin 21 parag.2 nën-parag.2.1 dhe 2.2 sepse aplikacionet nuk kanë pasur të bashkangjitur dëshmitë mbi

kualifikimet, përvojën, vlerësimet në dy vitet e fundit përveç një kandidati, nenit 24 paragrafi 1 dhe 2 ku konstatohet se testimi me shkrim është mbajtur më datën 22.02.2011, nuk janë njoftuar kandidatët për rezultatin dhe organizimin e testit me gojë dhe ka kaluar afati ligjor për procedim, sipas nenit 26 që ka qenë 5 ditë, poashtu vlerësimi i testit nuk është bërë në pajtim me nenin 37.

3. Për postet të cilat i mbajnë ushtruesit e detyrës që nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj (neni 30 paragrafi 4 i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës) në afatin sa më të shkurtër duhet të iniciohet dhe procedohet përmes avancimit sipas nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në rast të plotësimit të ndonjë pozite të lirë të nivelit drejtues të veprohet konform nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe konform nenit 10 pika 1.2 dhe nenit 16.1.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të ftohet Këshilli që të marr pjesë si vëzhgues në komisionin intervistues.
4. Të zëvendësohen kontratat e punës me shkresë-emërime në pajtim me nenin 96 dhe 97 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
5. Të formohen Komisionet disiplinore dhe Komisionet për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave, konform nenit 70 paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe nenit 81 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 82 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
6. Në rast të paraqitjes në Komision disiplinor apo në komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të ndonjë shërbyyesi civil, sipas nenit 12 pika 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, këto komisione duhet të zgjedhin ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditë.
7. Të standardizohen Përshkrimet e punës në pajtim me nenin 6 dhe 9 të Rregullores nr. 03/2010 për Përshkrimin e detyrave të punës.

II. Rekomandimet të përmbushen në afat prej dy muajve nga dita e pranimit të tij dhe të njoftohet Këshilli.

Rekomandimi i u dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm,
- Menaxher të personelit dhe
- Arkivit të Sekretariatit të Këshillit.

